

E drejta për informim

Newsletter mujor mbi mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për të Drejtën e Informimit

Newsletter është publikim i Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale

Fokusi i muajit

Prezantimi i Raportit të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale për vitin 2021 në Kuvendin e Republikës së Shqipërisë

Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, z. Besnik Dervishi, në seancën plenare të datës 28 prill 2022 të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, paraqiti "Raportin për veprimtarinë e Zyës së Komisionerit për vitin 2021". Në përputhje me procedurën, Kuvendi miratoi dhe Rezolutën "Për vlerësimin e punës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale për vitin 2021".

Në fjalën e tij Komisioneri, shprehu "Rëndësinë e veçantë në vendosjen e objektivave për veprimtarinë e Zyrës, i kushtohet 2 dokumenteve strategjike siç janë Progres Raporti i Bashkimit Evropian për Shqipërinë dhe Raporti i Monitorimit i hartuar nga SIGMA, të cilët shërbejnë si një barometër për punën tonë.

Pavarësisht se notat për Zyrën e Komisionerit, në këto dy dokumente, kanë qenë pozitive për vitin 2021, nuk mendojmë se ka vend për entuziazëm, pasi ka ende shumë për të bërë përpara. Sa i takon fushës së të drejtës së informimit, Zyra e Komisionerit e ka vendosur fokusin e saj tek instrumenti i Programit të Transparencës, i cili nuk është tjetër veçse garantimi i aksesit pa kërkesë në informacionin më thelbësor lidhur me një autoritet publik.

Raportin e plotë për veprimtarinë e Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale për vitin 2021, mund ta gjeni në link-un <https://www.idp.al/wp-content/uploads/2016/10/RAPORTI-VJETOR-2021.pdf>

Përmbledhje mujore e vendimeve dhe rekomandimeve

Vendim Nr. 06 - Bashkia Cërrik

Vendim Nr. 07 - Avokatura e Shtetit

Vendim Nr. 08 - Banka e Shqipërisë

Vendimmarrja e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale

TRANSPARENCA E AUTORITETEVE
PUBLIKE ËSHTË NJË NGA SHTYLLAT
E MIRËQEVERISJES

VIZITONI WWW.IDP.AL

#informim #transparencë #vendim

Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, gjatë muajit prill 2022, ka dhënë 3 vendime urdhërimi në zbatim të ligjit 119/2014 "Për të drejtën e informimit" (LDI).

Me anë të vendimit nr. 7 datë 15.04.2022, Zyra e Komisionerit ka vendosur pranimin e ankesës ndaj "Avokaturës së Shtetit" me objekt "Ankim ndaj refuzimit për dhënie informacioni dhe kopje të dokumenteve zyrtare".

Kërkuesi ka kërkuar informacion lidhur me firmat apo subjektet e kontraktuara nga ana e Shtetit Shqiptar për përfaqësimin e tij në arbitrazhin ndërkombëtar dhe koston e kontraktimit të përcaktuar në kontratën e lidhur me këto firma për 22 çështjet e listuara.

Autoriteti Publik në përgjigje të tij ka sqaruar se: "Avokatura e Shtetit është institucion qendror i administratës publike, i ngarkuar ekskluzivisht për dhënien e asistencës juridike. Sa i përket çështjeve të listuara në kërkesë, konkretisht nëse këto çështje janë përfaqësuar nga firma apo subjekte të kontraktuara nga ana e shtetit shqiptar dhe se cilat janë firmat e kontraktuara, se sa ka qenë kosto e kontraktimit e përcaktuar në kontratën e lidhur me këto firma për secilën prej çështjeve, komunikojmë se ky infomacion, në zbatim të ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit" jepet përkatësisht sipas parashikimeve të ligjit nr. 9643, datë 20.12.2006, "Për prokurimin publik", dhe të ligjit nr. 125/2013 "Për koncesionet dhe partneritetin publik privat". Institucioni i Avokaturës nuk kontraktton/prokuron në zbatim të Ligjit të Prokurimit Publik, por në bazë të akteve nënligjore të saj, në zbatim të Ligjit organik "Për Avokaturën e Shtetit", i ndryshuar. Gjithashtu, referuar parashikimeve të ligjit nr.10018/2008, i ndryshuar dhe VKM nr.392/2009, Avokatura e Shtetit nuk mban të dhëna mbi kostot e proceseve. Ato i transmetohen organit publik të interesuar për të cilin janë zhvilluar procedurat e kontraktimit".

Për sa më sipër, me pretendimin se është cenuar në të drejtën për informim, ankuesi i është drejtuar Zyrës së Komisionerit duke kërkuar ushtrimin e kompetencave, që i njeh ligji për rastet e refuzimit të dhënies së informacionit si dhe urdhërimin e Autoritetit Publik për dhënien e dokumentacionit të cituar në kërkesën për informacion.

Zyra e Komisionerit pas shqyrtimit paraprak të ankesës, bazës ligjore dhe rrethanave të faktit të paraqitura në të, vlerësoi se ankesa përmbush kriteret formale ligjore, në përputhje me përcaktimet e nenit 24 të ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit" (në vijim "LDI").

Pas vijimit të ankimit, me qëllim verifikimin e fakteve dhe rrethanave, që mund të jenë bërë pengesë për vënien në dispozicion të informacionit të kërkuar, Zyra e Komisionerit vendosi zhvillimin e hetimit administrativ pranë Autoritetit Publik duke ndjekur të gjithë etapat e procedurës administrative duke filluar nga kërkesa për parashtrime, zhvillimi i inspektimi si dhe seanca dëgjimore midis palëve.

Në lidhje me pretendimet e Autoritetit Publik për mos mbajtjen e informacionit të kërkuar dhe për këtë arsye refuzimin e dhënies së tij, argumentat e dhëna në të gjitha fazat e hetimit administrativ mund ti gjeni të pasqyruara në Vendimin nr. 7 datë 15.04.2022 .

Pas konsultimit të legjislacionit të posaçëm dhe dokumentacionit të administruar gjatë hetimit administrativ, Komisioneri vlerësoi se, qëndrimi i mbajtur nga ana e Autoritetit Publik nuk është në përputhje me dispozitat dhe parimet e LDI.

Nga tërësia e argumentave të paraqitura nga Autoriteti Publik, për refuzimin e vënies në dispozicion të informacionit të kërkuar, së pari vlerësohet se ato janë kontradiktore dhe të pabazuara në asnjë dispozitë ligjore apo provë që të legjitimojë kufizimin e dhënies së informacionit sipas nenit 17 të LDI. Autoriteti Publik referon ndër të tjera si shkaqe kufizimi të informacionit, konfidencialitetin e procedurave të arbitrazhit, por edhe konfidencialitetin në marrëdhënien Autoritetit Publik avokatë/zyra avokatie të kontraktuara për përfaqësimin e shtetit shqiptar në proceset e arbitrazhit.

Në përfundim, Zyra e Komisionerit vendosi urdhërimin e autoritetit publik për vënien në dispozicion të informacionit të kërkuar duke respektuar kufizimet në përputhje me pikën 6 të nenit 17 të ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit". Për tu njohur me vendimin e plotë të Zyrës së Komisionerit klikoni <https://www.idp.al/wp-content/uploads/2022/01/Vendim-7.pdf>.

Pjesëmarrje në Konferencën “Mos u rrej! Dita Ndërkombëtare e Verifikimit të Fakteve në Shqipëri”

Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale ishte e ftuar në Konferencën Kombëtare “Mos u rrej! Dita Ndërkombëtare e Verifikimit të Fakteve në Shqipëri” të organizuar nga “Faktoje.al”.

Në fjalën e tij përshëndetëse, Komisioneri, z. Besnik Dervishi, e vuri theksin në bashkëpunimin me organizatat e shoqërisë civile dhe median, si një faktor për rritjen e kulturës së transparencës dhe ofrimin e shërbimeve me standarde nga administrata publike.

Faktoje.al është një nga grupimet më aktive të viteve të fundit dhe që e ka mirëpërdorur të drejtën për informim. E drejta për informim është e lidhur ngushtë me lirinë e shprehjes. Thelbësor është fakti se Shqipëria ka një legjislacion modern. Forcimi i marrëdhënieve me shoqërinë civile dhe median, veçanërisht me atë investigative, është i rëndësishëm dhe vlerësoj, se këto grupime kanë gjetur te Zyra e Komisionerit një institucion publik me të cilin diskutohet hapur. Nga ana tjetër, autoriteti nëpërmjet vendimmarrjes ka dhënë kontribut me jurisprudencë në këtë fushë, e cila duhet zhvilluar e konsoliduar më tej” - tha ndër të tjera z. Dervishi. Dita Ndërkombëtare e Kontrollit të Fakteve (International Fact-Checking Day) është 2 prilli, prej vitit 2017.



Bashkëpunimi me organizata të shoqërisë civile për zbatimin e të drejtës për informim



Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale zhvilloi takime informuese e konsultuese me organizatat e shoqërisë civile “Qëndresa qytetare” dhe “Mjaft”. Në fokus të tyre ishte vlerësimi i ecurisë së zbatimit të legjislacionit të të drejtës për informim dhe bashkëpunimi në kuadër të projekteve që forcojnë dhe nxisin transparencën dhe llogaridhënien e Autoriteteve Publike.

Me organizatën “Qëndresa qytetare” u fol për veprimtarinë e institucioneve të sektorit shëndetësor dhe për ato të arsimit të lartë. Veçanërisht, u trajtuan çështje për adresimin e problematikave të konstatuara për kërkesat/ankesat në raport me këto Autoritete Publike. Me interes, u diskutua edhe për mundësinë e nisjes së një konsultimi më të gjerë për krijimin e një Programi Transparence të dedikuar për institucionet arsimore të të gjitha niveleve.

Me organizatën “Mjaft” bashkëbisedimi u fokusua në ecurinë e zbatimit të projektit “Përgjegjshmëria, teknologjia dhe hapja institucionale në Shqipëri” nga disa kategori Autoritetesh Publike. Aktualisht, kjo shoqatë është në fazën e mbledhjes së të dhënave nëpërmjet pyetësorëve të posaçëm, ndërsa u trajtuan çështje që kanë të bëjnë me përmbushjen e detyrimeve ligjore në këtë proces. Në takim u shkëmbyen mendime edhe për mundësinë e angazhimit të Zyrës së Komisionerit në këtë projekt.



Për forcimin e kulturës së transparencës nga Autoritetet Publike dhe për garantimin e të drejtës për informim të qytetarëve, institucioni është gjithnjë i gatshëm e i hapur të bashkëpunojë me organizatat e shoqërisë civile. Ky bashkëveprim është udhëhequr nga zbatimi i praktikave dhe përvojave më të mira në funksion të interesit publik.